



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -116

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-101 PËR
FONDET PENSIONALE TË KOSOVËS, I NDRYSHUAR DHE
PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-115 DHE LIGJIN NR. 04/L-168**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-101
PËR FONDET PENSIONALE TË KOSOVËS, I NDRYSHUAR DHE
PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-115 DHE LIGJIN NR. 04/L-168**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 10, 8 maj 2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 (Gazeta Zyrtare, Nr. 25, 7 shtator 2012) dhe Ligjin 04/L-168. (Gazeta Zyrtare, Nr. 8/, 8 prill 2013), (në tekstin e mëtejme: ligji bazik).

Neni 2

1. Neni 4, paragrafi 6 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim:

4.6. Komisioni për përzgjedhje i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira për emërim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje përbëhet nga Guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i Përgjithshëm dhe Ministri i

Financave. Mandati i rregullt i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat katër (4) vjet, me mundësi të rizgjedhjes. Nëse ndonjë anëtar jep dorëheqje apo largohet për shkaqe të tjera, anëtari i ri emërohet për mandatin e plotë. Nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues vazhdojnë mandatin tyre vetëm për nëntëdhjetë (90) ditë.

2. Neni 4, paragrafi 8 i ligjit bazik, në fund të paragrafit shtohet teksti si më poshtë dhe nën paragrafët me numër rendor 4.8.1. dhe 4.8.2, si në vijim:

Komisioni për përzgjedhje i propozon kandidatët Kuvendit:

4.8.1. së paku nëntëdhjetë (90) ditë para se të skadojë mandati i një anëtari ekzistues; dhe

4.8.2. jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas humbjes së mandatit të cilësdo pozitë në Bordin Drejtues për shkak të dorëheqjes, rast vdekjeje apo shkarkim nga Kuvendi.

Neni 3

1. Neni 7, paragrafi 5 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

7.5. Fondi sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit të informohen për kontributet, datat e kontributeve, shumën e fituar nga investimi dhe mjetet në llogarinë individuale, për vitin raportues. Informimi bëhet si në vijim:

7.5.1. të gjithë pjesëmarrësit aktivë që kanë pasur transaksione brenda një viti kalendarik, pas përfundimit të atij viti kalendarik pranojnë raportin përmes dërgesës postare ose përmes postës elektronike; dhe

7.5.2. pjesëmarrësit të cilët nuk kanë pasur transaksione në llogarinë e tyre individuale, pranojnë raport së paku tre (3) vjet pas raportit të fundit që kanë pranuar.

2. Neni 7, paragrafi 10 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

7.10. Në rastet kur kontributet nuk dërgohen në llogaritë individuale si pasojë e mos identifikimit të punëdhënësit, ose punëdhënësi nuk ka dërguar listën e punëtorëve apo punëdhënësi ka dërguar më shumë mjete se që ka në listën e punëtorëve, shuma e paidentifikuar së bashku me fitimin apo humbjen, evidentohen nga Fondi në një llogari të veçantë.

3. Neni 7 i ligjit bazik, pas paragrafit 10 shtohen paragrafët e ri me numër rendor 7.11 dhe 7.12, me tekstin si në vijim:

7.11. Fondi në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës në vazhdimësi zhvillon aktivitete për identifikimin e kontributeve të pidentifikuara. Në rast se për kontributet përkatëse nuk identifikohen paguesit nga ana e Fondit dhe nuk ka as lajmërim nga ana e vet paguesve deri në gjashtë (6) vjet nga viti i pagesës, atëherë Qeveria e Republikës së Kosovës e ka të drejtën e marrjes së vendimit për inkasimin e Fondeve përkatëse në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Një vendim përkatës merret vetëm pasi që Bordi i Fondit të ketë informuar me shkrim Qeverinë që ka shtjerrë të gjitha mundësit e identifikimit të paguesve të kontributeve përkatëse.

7.12. Në rast të identifikimit të paguesëve të kontributeve pas afatit gjashtë (6) vjeçar, mjetet e inkasuara sipas paragrafit 11 të këtij neni i kthehen Fondit, së bashku me kamatën ekuivalente me fitimin mesatar që ka pasur Fondi gjatë kësaj periudhe.

Neni 4

1. Neni 9, paragrafi 9.9 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

9.9. Përpjesëtimi maksimal i mjeteve të tërësishme të pensionit, që mund të investohen në mjetet e një emetuesi, duke përfshirë llogaritjen e mjeteve të personave të ndërlidhur, është pesë përqind (5%) për aksione, tridhjetë përqind (30%) në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, njëzet përqind (20%) për obligacione të vlerësuara “AA” ose më lart, dhjetë përqind (10%) për obligacione të vlerësuara “A” ose më lart, pesë përqind (5%) për obligacione të vlerësuara “BBB” ose më e ultë, dhe një përqind (1%) për obligacione të vlerësuara “BB+” apo më ulët. Përpjesëtimi maksimal i mjeteve të tërësishme të pensionit, që mund të investohen në obligacione të vlerësuara “BB+” apo më ulët nuk duhet të tejkalojë pesë përqind (5%) të mjeteve të tërësishme. Vlerësimi kreditor duhet të jetë nga një agjenci e mirënjohur ndërkombëtarisht për vlerësim kreditor, dhe nënkupton edhe vlerësimet ekuivalente që mund të shënohen me grada apo shkronja ndryshe.

2. Neni 9, paragrafi 10 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

9.10. Kufizimet në investime në një emetues të vetëm të parapara në paragrafet 9.8 dhe 9.9 të këtij ligji nuk vlejnë për investimet në një instrument për investime të hapura apo për investimet në fondet e tregtuara në bursa (Exchange Traded Fund), me kusht që përpjestimi i mjeteve të tërësishme të pensionit të investuara në një emetues të vetëm të jenë në përputhje me paragrafët 9.8 dhe 9.9 të këtij ligji.

Neni 5

Neni 10, paragrafi 1 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

10.1. Menaxhuesit e mjeteve që angazhohen për ta kryer menaxhimin e një pjese të mjeteve pensionale apo të të gjitha mjeteve pensionale të Fondit, e bëjnë këtë vetëm në përputhje me marrëveshjet për menaxhim të mjeteve pensionale të lidhura në

pajtim me këtë ligj dhe me rregulloret e tjera në fuqi. Menaxhuesit e mjeteve dhe punonjësit e tyre që kanë liri veprimi me mjetet pensionale duhet të jenë fiduciarë të Fondit.

Neni 6

Neni 11, paragrafi 6, fshihet nga teksti i ligjit bazik.

Neni 7

Neni 12, paragrafi 18 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

12.18. Të punësuarit e huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë, të cilët nuk kanë qenë të obliguar të paguajnë kontribute pensionale sipas legjislacionit në fuqi, dhe nuk janë të obliguar të kontribuojnë me ligjet në fuqi, mund t'i tërheqin mjetet e tyre të akumuluar me anë të një pagese të vetme.

Neni 8

1. Neni 29 i ligjit bazik, titulli nenit ndryshohet në vijim:

Neni 29 ***Zgjidhja e kontesteve në lidhje me kursimet pensionale***

2. Neni 29, paragrafi 1, 2 dhe 3, fshihen nga teksti i ligjit bazik.

Neni 9

1. Neni 35 i ligjit bazik, titulli i nenit ndryshohet si në vijim:

Neni 35 ***Të drejtat në lidhje me kursimet pensionale***

2. Neni 35, paragrafi 1 fshihet nga teksti i ligjit bazik.

Neni 10

Neni 37, paragrafët 1, 2 dhe 3 të ligjit bazik, ndryshohen si në vijim:

37.1. Kontributet e dhëna nga një punëdhënës në FKPK apo në një Fond plotësues pensional, sipas nenit 6 të ligjit, në të mirë të punonjësve të tij konsiderohen shpenzim operativ dhe zvogëlojnë rezultatin operativ të punëdhënësit për qëllim të tatimeve.

37.2. Kontributet e dhëna nga punonjësi në FKPK apo në një Fond plotësues pensional, sipas nenit 6 të ligjit, nuk janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale.

37.3. Çdo pagesë qoftë në formën e një tërheqje fazore, ose pagesë për blerjen e një pensioni vjetor nga FKPK apo një Fond plotësues pensional mund të jetë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale në momentin kur pagesa është bërë dhe pranuar nga pjesëmarrësi, të gjitha në përputhje me Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Neni 11

Pas nenin 37 të ligjit bazik, shtohet nen i ri me numër rendor 37A, me tekstin si në vijim:

Neni 37A

Komiteti i Auditimit, Auditimi i brendshëm, dhe Auditimi i jashtëm

1. Bordi drejtues në FKPK apo në një Fond plotësues pensional themelon komitetin e auditimit, anëtarët e të cilit zgjedhën në mesin e bordit drejtues dhe ekspertëve të jashtëm. Shumica e anëtarëve të komitetit të auditimit janë anëtarë të bordit drejtues. Së paku një anëtar i komitetit të auditimit duhet të jetë ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit, i cili është i pavarur nga menaxhmenti dhe Bordi drejtues.
2. Bordi drejtues në FKPK apo në një Fond plotësues Pensional me rekomandimin e komitetit të auditimit, cakton një auditor të jashtëm të kualifikuar dhe të pavarur, të miratuar nga BQK-ja.
3. Bordi drejtues në FKPK apo në një Fond plotësues pensional emëron një auditor të brendshëm i cili i raporton komitetit të auditimit dhe që funksionon në mënyrë të pavarur nga menaxhmenti i fondit pensional.

Neni 12

Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, mandati i anëtarëve aktual të Bordit Drejtues vazhdon deri në skadimin e mandatit të tyre të përcaktuar me Vendimin nr. 04-V-840, datë 6 maj 2014 dhe Vendimin nr.05-V-164, datë 30 nëntor 2015, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-116
23 dhjetor 2016

Kadri Veseli

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës